



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____._____.2021

V E N D I M

Nr. _____, Datë _____._____.2021

Mbështetur në Ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, pranë Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi është paraqitur ankesa nr. 82, datë 22.07.2020, e bërë nga B.S kundër Drejtorisë Vendore Tiranë Jug të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në të cilën pretendohet për diskriminim për shkak të “racës”¹.

Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në formularin e ankesës, subjekti ankues informon se: *“Ka bërë vetdeklarimin për të legalizuar objektin e ndërtuar pa leje në vitin 2006. Vetdeklarimi është pranuar nga ana e institucionit përgjegjës, por prej vitit 2006 e deri në vitin 2019, nuk është pajisur me lejen e legalizimit. Referuar afateve ligjore, shohin se nuk janë respektuar afatet nga ana e institucionit për legalizimin e objektit. Me shkresën nr. 3802/1 prot, datë 01.06.2020 është njoftuar nga ASHK, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, se referuar akt-ekspertizës të kryer nga instituti ndërtimit me nr.242/1 prot, datë 11.07.2019, përjashtohet nga procesi legalizimit me arsyen se nuk plotëson kriteret ligjore për tu legalizuar. Argumenti i ASHK është se çatia është e mbuluar me llamarinë. Referuar akt-ekspertimit të kryer privatisht nga një ekspert, por dhe situatës faktike, vihet re se objekti i plotëson kriteret dhe nuk është i mbuluar me llamarinë, por me tjegulla. Ankuesi pretendon se skualifikimi nga procesi i legalizimit është për shkak se i përket minoritetit rom”.*

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit dhe marrjen e lejes së legalizimit.

¹ Referuar Vërtetimit datë 20.07.2020 të Shoqatës “Qendra T’REJA”, B.S është anëtar i Komunitetit Rom.

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, përcaktohet se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzëninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”*.

Neni 7 i LMD-së², në pikën 1 të tij, parashikon se: *“Çdo veprim apo mosveprim i autoriteteve publike ose i personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë apo privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash, ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta apo të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë apo grupe personash, përbën diskriminim”*.

Bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Gjatë shqyrtimit të kësaj anekse, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga Ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32/2 dhe 33 të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

Pas shqyrtimit paraprak të saj, u konstatua se ankesa e depozituar pranë Komisionerit kishte mangësi të anës formale, lidhur me shpjegimet e dhëna nga ana e subjektit ankues, në lidhje me shkakun e pretenduar dhe lidhjes shkakësore, ndërmjet trajtimit më pak të favorshëm dhe shkakut të mbrojtur.

- Për këtë arsye, me e-mail-in datë 29.07.2020, inspektori i çështjes, i ka kërkuar ankuesit të paraqesë shpjegime, lidhur me identifikimin e shkakut të pretenduar për diskriminim, çfarë kërkon nga Komisioneri dhe ka kërkuar kopje të kërkesave drejtuar Drejtorisë Vendore Tiranë Jug, agjencive të tjera, apo nëse i është drejtuar gjykatës.

Në përgjigje të kërkesave të mësipërme, ankuesi me e-mail-et datë 10 dhe 13.08.2020 ka dhënë parashtrimet e tij si dhe ka dërguar kopje të akt ekspertimit të banesës.

² Shkurtesë për Ligjin për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Në këto kushte, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi filloi procedurat përkatëse për shqyrtimin e saj.

- Me shkresën nr. 1071/1, datë 30.07.2020, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka njoftuar dhe kërkuar informacion nga, Drejtoria Vendore Tiranë Jug të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës për ankesën e bërë nga B.S dhe ka kërkuar aktet e poshtëcituara:
 - Kopje të plotë të praktikës shkresore/procedurës së ndjekur nga ana e drejtorisë, lidhur me rastin e legalizimit të banesës së B.S si dhe shkresën nr. 242/1, datë 11.07.2019 të institutit të Ndërtimit.
 - Informacion, nëse ka praktika të njëjta apo të ngjashme për persona të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, për të cilët nga ana tyre është ndjekur e njëjta praktikë. Kopje të praktikave të ngjashme për të cilat nuk është vijuar me procedurat e legalizimit.

Me shkresën nr. 12047/1, datë 13.08.2020, Agjencia Shtetërore e Kadastrës në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Nga verifikimet e kryera në bazën qendrore të të dhënave, subjekti me gjeneralitete B.S është aplikues për legalizim me vetëdeklarim nr. 2884, datë 11.02.2005, pranë Njesisë Administrative nr. 6, Tiranë. Pas verifikimeve të kryera rezulton se: IMT e Bashkisë Tiranë me shkresën nr.13958, datë 28.04.2020, nga inspektimi në zonën që kufizohet nga rrugët “Konferenca e Pezës” dhe “Hamdi Pepa” ku ndodhet “Tregu i rrobave të përdorura” të Komunitetit Rom, ka identifikuar 28 objekte informale 1 dhe 2 kate (ku përfshihet objekti informal në posedim të B.S), duke kërkuar informacion lidhur me statusin juridik të pasurive dhe objekteve që ndodhen në këtë territor, pasi referuar shkresës, kjo zonë do të nënshtrohet rehabilitimit nga Bashkia Tiranë, e cila është në fazën e hartimit të projektit konkret. Në vijim, me shkresën nr.5378/1, datë 02.06.2020, Drejtoria Tirana Jug ka informuar IMT-në e Bashkisë Tiranë se për këto 28 objekte nuk ka vendimmarrje, pasi nuk kanë përfunduar ende procedurat administrative”.*

Me shkresën nr. 8142/2, datë 17.08.2020 dhe nr. 8142/3, datë 25.08.2020, Drejtoria Vendore Tiranë Jug e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: *“Pranë drejtorisë administrohet praktika e legalizimit nr. 2448, datë 11.02.2005, në emër të B.S. Pranë Drejtorisë Rajonale të Aluizni-t Tirana Jug është administruar njoftimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për çështjen me nr.akti 7562, datë 01.11.2016, me paditës B.S, i paditur Bashkia Tiranë, ZVRPP Tiranë, person i tretë Drejtoria Rajonale e Aluizni-t Tirana Jug, me objekt “njohje pronar”. Në vijim të sa më sipër, në zbatim të nenit 26 të Ligjit nr. 9482, datë 03.04.2006 “Për legalizimin ...”, i ndryshuar, është vijuar me pezullimin e procedurave të legalizimit për këtë objekt. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka përfunduar gjykimin në themel të çështjes dhe me anë të Vendimit nr.4462, datë 22.05.2017 ka vendosur rrëzimin e kërkesë padisë. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim pranë Gjykatës së Apelit Tiranë paditësi B.S dhe Gjykata e Apelit me Vendimin nr. 734, datë 16.09.2019 ka vendosur lënien në fuqi të Vendimit nr. 4462, datë 22.05.2017. Në vijim të rifillimit të procedurave për këtë objekt dhe*

shqyrtimit të praktikave të legalizimit të disa banorëve të Komunitetit Rom dhe Egjiptian, referuar kërkesave të tyre paraqitur pranë drejtorisë, u vijua me verifikimin në terren të gjendjes faktike. Referuar pikës 1 të VKM-së nr. 280/2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje .. .”, i ndryshuar, kushtet minimale konstruktive që duhet të plotësojë ndërtimi pa leje, janë: a) kanë, minimalisht, të ndërtuar një kat mbi ose nëntokë, b) janë të ndërtuara me materiale të qëndrueshme, të ngritura të paktën në strukturë dhe plotësojnë kushtet për regjistrim, sipas legjislacionit për regjistrimin e pasurive të paluajtshme. Nga verifikimi në terren, rezulton se këto objekte janë të mbuluara me llamarinë/materiale të tjera të lehta. Nisur nga sa më sipër dhe referuar nenit 27 të Ligjit nr. 9482/2006 “Për legalizimin ...”, i ndryshuar, (dokumentacioni tekniko-ligjor për legalizimin e ndërtimit informal përfshin: e) akt-ekspertizë nga një ekspert ose ent i licencuar për qëndrueshmërinë konstruktive të objektit, për ndërtimet me lartësi mbi 4 kate), subjektet kanë paraqitur pranë drejtorisë akt-ekspertizë për qëndrueshmërinë e objekteve, përgatitur nga arkitekte L.B. Ndodhur në këto kushte, drejtoria i është drejtuar për interpretim në lidhje me aktin e ekspertizës së depozituar, Drejtorisë së Përgjithshme të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, e cila ka sugjeruar që për një gjykim përfundimtar t’i drejtohen Institutit të Ndërtimit. Në përgjigje të kërkesës, Instituti i Ndërtimit, me shkresën nr. 242/1, datë 11.07.2019, ka informuar se akt-ekspertiza nuk është në përputhshmëri adekuate me dokumentat normative në fuqi të specifikuara nga organet shtetërore përgjegjëse. Për sa më sipër, ndodhur në kushtet që është vlerësuar se akti i ekspertizës nuk është në përputhshmëri adekuate me dokumentat normative në fuqi dhe objekti nuk garanton qëndrueshmëri konstruktive, nuk është vijuar me procedurat e legalizimit. Me tej, subjektet paraqitën pranë drejtorisë akt-ekspertim të përgatitur nga ark. L.B dhe ing.gjeod. G.S, duke plotësuar të metat e aktit të mëparshëm. Ndodhur në këto kushte, në funksion të vijimit të procedurave të mëtejshme, me anë të shkresës nr. 8242, datë 10.08.2020 i jemi drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë me kërkesë për informacion nëse objekti i paraqitur për legalizim në emër të B.S cenon infrastrukturën rrugore dhe nëse preket nga ndonjë projekt i miratuar zhvillimi. Për sa më sipër, nga ana e drejtorisë nuk janë përmbyllur procedurat e legalizimit me vendim kualifikimi/përfundimi për objektin e deklaruar nga B.S, për sa kohë jemi në pritje të një përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë për të vijuar me procedurat e mëtejshme në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi”.

- Mbështetur në nenin 33/8, të Ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, për shqyrtimin e mëtejshëm të ankesës, Komisioneri me shkresën nr. 1071/3, datë 14.10.2020 njoftoi palët për zhvillimin e seancës dëgjimore më datë 27.10.2020, ora 11.00, duke kërkuar shpjegime dhe kopje të dokumenteve si më poshtë:
 - Informacion lidhur me statusin juridik të objekteve të banimit që janë në kushtet e banesës së B.S dhe kanë përfunduar procesin e legalizimit (objekte banimi që

- ndodhen në afërsi të banesës së B.S). Sa nga këto objekte banimi i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian dhe sa nuk i përkasin komuniteti rom dhe egjiptian.
- Informacion, sa objekte banimi (që ndodhen në zonën objekt shqyrtimi) janë në proces legalizimi dhe presin përgjigje nga Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit të Bashkisë Tiranë. Sa prej këtyre objekteve i përkasin komunitetit rom dhe egjiptian.
 - Informacion nëse ka objekte banimi të vetëdeklaruar që në vitin 2005 dhe kanë përfunduar procesin e legalizimit (të cilët ndodhen në zonën objekt shqyrtimi).
 - Informacion, nëse ka praktika të njëjta apo të ngjashme për persona të ndodhur në kushte të njëjta apo të ngjashme me ankuesin, për të cilët nga ana juaj është ndjekur e njëjta praktikë. Kopje të praktikave të ngjashme për të cilat nuk është vijuar me procedurat e legalizimit.
 - Kopje të vendimeve të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, nr. 4462, datë 22.05.2017 dhe nr. 734, datë 16.09.2019, me palë paditëse B.S.
 - Kopje të shkresave nr. 1684/1, datë 21.06.2019 dhe nr. 875/1, datë 07.06.2019 të Drejtorisë Vendore ASHK Tirana Jug drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK.
 - Kopje të raportit të parë të interpretimit mbi akt-ekspertimin e ndërtesës së B.S të hartuar nga Instituti i Ndërtimit (shkresa nr. 242/1, datë 11.07.2019 e dërguar me shkresën nr. 8142/2, datë 17.08.2020, i përkiste shtetasit G.I).
 - Kopje të shkresës dhe listës bashkëngjitur nr. 13958, datë 28.04.2020 të Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit të Bashkisë Tiranë drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të ASHK-së.

Në seancë dëgjimore mori pjesë vetëm përfaqësuesi me deklaratë i subjektit ankues, G.S³. Drejtoria Vendore Tiranë Jug nuk u paraqit⁴, dhe si rrjedhim seanca u zhvillua në mungesë të saj. Gjatë seancës dëgjimore, përfaqësuesi i ankuesit, deklaroi se në vijim do të vinte në dispozicion të Komisionerit, informacion shtesë lidhur me ankesën e paraqitur nga B.S.

Në vijim të komunikimit, përfaqësuesi i subjektit ankues, G.S me e-mail-in datë 29.10.2020 ka informuar se: *“Në datë 04.05.2018 së bashku me banorët e tjerë B.S i është drejtuar me kërkesë Bashkisë Tiranë, për tu informuar nëse ka Plane të Detajuara Vendore në zonën ku ndodhen ndërtesat. Me shkresën Nr. S9375/1, datë 04.05.2018, Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Tiranë është përgjigjur se, territori në të cilën ndodhen ndërtesat, është njësi strukturore TR/102, për të cilën nuk ka Plan të Detajuar Vendor (PDV) të miratuar apo kërkesë nga subjekte ndërtuese dhe individë për zhvillimin e njësisë strukturore. Në datë 19.02.2019 aktivistët e Fuqizimit Ligjor të Komunitetit Egjiptian dhe Rom, u informuan nëpërmjet komunikimit elektronik me ARRSH-në se, ndërtesat nuk prekeshin nga rrugët dytësore të “Unazës së Re”. Për sa më sipër, shohim se institucioni ka mbajtur qëndrime të ndryshme në*

³ Deklaratë datë 26.10.2020.

⁴ Drejtoria Vendore Tiranë Jug ka marrë dijeni me, Lajmërim Marrje Poste RR467866637AA, datë 15.10.2020.

lidhje me procesin e legalizimit të ndërtesës së B.S. Ndërkohë që, këto qëndrime kanë qenë të pabazuara në një analizë tekniko-ligjore apo në ndonjë vendim/projekt të miratuar. Kjo tregon qartazi trajtimin e pabarabartë të B.S dhe familjeve të tjera egjiptiane dhe rome krahasuar me familjet e maxhorancës (M.S, Y.C, I.H) të cilët jetojnë në të njëjtën zonë dhe kanë përfunduar procesin e legalizimit. Si pasojë e këtyre qëndrimeve, B.S është vonuar në përfundimin e procesit të legalizimit dhe si pasojë mund të preket nga projekte publike që mund të miratohen në vitet në vazhdim nga ana e Bashkisë Tiranë. Pasojat që mund të vijnë nga ky trajtim i pabarabartë janë dhe në shkelje të afateve ligjore të përcaktuara në VKM-në nr. 280, datë 01.04.2015 “Për përcaktimin e kriterëve, procedurave e dokumentacionit të zbatueshëm për të kualifikuar ndërtimet pa leje, shtesat anësore dhe/ose në lartësi, në ndërtime me leje” (i ndryshuar)”.

Me shkresën nr. 10989/1, datë 18.11.2020, Drejtoria Vendore Tiranë Jug, në mes të tjerash informoi Komisionerin se: “Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit me shkresën nr. 26887/3, datë 25.09.2020 ka informuar se territori i përcaktuar në hartën e njësisë strukturore TR/102, nuk ka aplikim për PDV (Plan të Detajuar Vendor). Sa më sipër Drejtoria Vendore Tiranë Jug do të marrë masa për vijimin e procedurave të mëtejshme të legalizimit në përputhje me kuadrin ligjor. Përsa i përket vijimit të mëtejshëm të shqyrtimit të dokumentacionit tekniko-ligjor dhe përmbylljes së proceseve të legalizimit, kërkohet mirëkuptim, pasi institucioni po ushtron veprimtarinë me një numër të reduktuar punonjësish, në kuadër të masave për të shmangur përhapjen e virusit COVID-19”.

- Në vijim të procedurës për shqyrtimin e ankesës, si dhe në zbatim të Urdhërit nr. 12, datë 20.01.2021 të Komisionerit, me datë 25.01.2021, u realizua inspektimi në mjediset e Drejtorisë Vendore Tiranë Jug. Inspektimi kishte si objekt të tij, marrjen e informacionit të drejtëpërdrejtë nga institucioni si dhe dokumentacionin shkresor përkatës.

Gjatë inspektimit, nga ana e përfaqësuesit të Drejtorisë Vendore Tiranë Jug, A.H, me detyrë Përgjegjës i Sektorit Juridik i Drejtorisë Vendore Tiranë Jug, u informuar se ishte shqyrtuar dosja e legalizimit të objektit të B.S dhe u vendos në dispozicion të grupit të inspektimit, Vendimi nr. 30, datë 22.01.2021 “Për legalizimin e ndërtimit pa leje” të objektit të poseduar nga B.S.

Referuar deklaratës, të dërguar me e-mail-in datë 25.01.2021, subjekti ankues ka deklaruar tërheqjen e ankesës së paraqitur pranë zyrës së Komisionerit, pasi është arritur qëllimi për të cilin kishte filluar ankesa.

Neni 33, pika 9 e Ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” ka parashikuar se: “Kur e sheh të përshtatshme, Komisioneri kërkon të arrijë marrëveshje pajtimi mes ankuesit dhe personit kundër të cilit është paraqitur ankesa”. Komisioneri vlerëson frymën bashkëpunuese të Drejtorisë Vendore Tiranë Jug të ASHK-së, lidhur me marrjen e masave për zgjidhjen me efektivitet të problematikës së objektit në pronësi të B.S.

Për sa më lart, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi vlerëson, se kërkesa e B.S është plotësuar, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është nisur ky hetim, në drejtim të pajisjes me lejen e legalizimit të objektit të B.S.

PËR KËTO ARSYE :

Mbështetur në nenet 3, 4, 7, pika 1, nenin 21, pika 1, nenin 32, pika 1, gërma a), si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I :

1. Të deklarojë të përfunduar procedurën administrative për shqyrtimin e ankesës nr. 82, datë 22.07.2020, paraqitur nga B.S kundër Drejtorisë Vendore Tiranë Jug të Agjencisë Shtetërore të Kadastrës, pasi është arritur efektiviteti dhe qëllimi për të cilin është filluar procedura hetimore.
2. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijeni.

KOMISIONER

Robert GAJDA